



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:260607
Datë: 21.11.2024
Numri i dokumentit: 06486970

C.nr. 2023:260608

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA KAÇANIK – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: E. D., B. D. dhe M. Ç. që të gjithë nga Kaçaniku, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. V. Rr. nga Prishtina rr. “...” nr.60, kundër të paditurës K. K. -D. Sh. M. S. , baza juridike: *Kompensim i pagës 13-të*, vlera e kontestit: 4,246.00 Euro, jashtë seancës, me datë 21.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura K. K. -D. Sh. M. S. që në emër të pagës së të 13-të të ia paguaj:

- **1) Paditëses:** E. D., t’ia paguajë pagën e 13-të, në lartësi prej një page bazë në shumën 787.00 euro për vitin 2020,2021 dhe vitin 2022, në shumën e tërësishme 2,361.00 euro
- **2) Paditëses:** B. D., t’ia paguajë pagën e 13-të, në lartësi prej një page bazë në shumën 377 euro, për vitin 2020,2021 dhe vitin 2022, në shumën e tërësishme 1,131.00 euro
- **3) Paditëses:** M. Ç., t’ia paguajë pagën e 13-të, në lartësi prej një page bazë në shumën 377 euro, për vitin 2022, në shumën e tërësishme 754.00 euro.

Gjithashtu ka kërkuar që të gjitha këto të paguhen me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e parashtrimit të padisë si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale, ndërsa gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar shumën prej 30€ në emër të takṣës për padi.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti: *Kompensim i pagës 13-të*, vlera e kontestit: 4,246.00, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Parashtruesit e kësaj padie janë të punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik. Kjo dëshmohet edhe me kopjet e bashkangjitura të kësaj padie. Me datën 12.06.2018 hynë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ku në bazë të kësaj marrëveshje parashtruesve të kësaj padie bazuar në nenin 17 par 2 i takon e drejta në një pagë pagë në lartësinë e pagës bazë dhe atë për vitin 2020. Përkundër obligimit ligjor që në mënyrë zyrtare të bëhet zbatimi i kësaj kontrate lidhur më këtë padi, dhe atë brenda afatit një mujor pas plotësimit të kushteve, deri me tanë parashtruesit te padisë nuk janë kompensuar për këto paga të trembëdhjeta ashtu siç parashihet në nenin 17 par 2 te Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi. Meqenëse Kontrata Kolektive Sektoriale nuk po zbatohet zyrtarisht ashtu siç është obligimi ligjor, Konsiderojmë se K. K. - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - QKMF Kaçanik, me kohë do duhej të bënин planifikimin e duhur buxhetor edhe për këtë obligim. Për më tepër paditësit pretendojnë se e paditura i ka pasur mundësitetë financiare për ta përbushur këtë obligim por të njëjtin ka dështuar ta realizojë më tepër për shkak të neglizhencës në ndërmarrje të veprimeve të duhura në drejtim të realizimit të të drejtave të punëtorëve të saj. Gjithashtu ka theksuar se e paditura ka pasur mundësi buxhetore përfaktin se në vitin 2020 e paditura e ka shpenzua vetëm 93% të buxhetit të saj dhe ka pasur suficit buxhetor me çka ka mundur të bëjë pagesën e këtyre kategorive, njëherit ka theksuar se pas analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të prezantuara i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësve të e aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të datës 24.10.2024 ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagat e 13-ta, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vitë kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditësve të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të, e të cilin fakt gjykata mund ta vërtetoj nga raporti financier përvit 2020, 2021, 2022e që rrjedhimisht që kjo kërkesë tashmë është parashkruar. Andaj,

nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e PABAZUAR.

Gjkata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse te çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se palët paditëse ishin të punësuara tek e paditura dhe se gjëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadisë, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

a) Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 7/1 të dt. 28.01.2013, e lidhur në mes të Komuna Kaçanik - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF-Kaçanik, në cilësi të punëdhënësit dhe paditës E. D. në cilësi të punëmarrësit, tek e paditura, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar dhe gjëzon shpërblimin në pagën bazë prej 757.54.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

b) Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 7/1 të dt. 28.01.2013, e lidhur në mes të Komuna Kaçanik - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF-Kaçanik, në cilësi të punëdhënësit dhe paditës B. D. në cilësi të punëmarrësit, tek e paditura, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar dhe gjëzon shpërblimin në pagën bazë prej 290.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

c) Në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës, me numër protokollit 7/1 të dt. 28.01.2013, e lidhur në mes të Komuna Kaçanik - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF-Kaçanik, në cilësi të punëdhënësit dhe paditëses M. Ç. në cilësi të punëmarrëses, tek e paditura, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura me kohë të pa caktuar dhe gjëzon shpërblimin në pagën bazë prej 290.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se “*Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit*”.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit te pagës se 13-të, për punëtoret shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitet financiare te punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbrush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. (*Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*).

Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti për paga dhe mëditje në Komunën e Kaçanik ka qenë 5,232.50 euro. Në nenin 12 par. 4 të këtij ligji është përcaktuar se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve “Mallra*

e shërbime” nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat.

Në anën tjetër, sipas raportit finansiar për komunën e Kaçanikut për vitin finansiar 2020 të publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, rezulton se buxheti final për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 5,232.50 euro ndërsa realizimi për vitin 2020 ka qenë 5,232.50 euro. ZKA ka konstatuar se te kategoria e pagave nuk ka asnë mbetje apo suficit të pa shfrytëzuar për vitin 2020 dhe realizimi i buxhetit për këtë kategori është 100%.

Nga Ligjet përkatëse të cituara si më lartë, përkatësisht në raport me zërat për ndarje buxhetore, rezulton se Komuna e Kaçanik nuk ka ndarë asnë linjë buxhetore për paga të 13-ta për vitin 2020, e në anën tjetër realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje është realizuar në atë masë sa nuk rezulton rezeve buxhetore për të mbuluar pagat e 13-ta për punonjësit, përkatësisht në rastin konkret paditësit.

Sa i përket pjesës së kërkesës për pagesën e pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022, gjykata konstaton se bazuar në faktin se Kontratës së lartcekur mbi bazën e së cilës pala paditëse e mbështetë themelësinë e kërkesëpadisë i ka skaduar afati i vlefshmërisë me dt.10.06.2021, rezulton se e njëjta ka pushuar të prodhojë efekt juridik. Në këtë kuptim, punëtorët shëndetësorë nuk mund t'i gjëzojnë beneficionet e përcaktuara me dispozitat e kësaj Kontrate edhe pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së të njëjtës, përfshirë edhe të drejtën e kompensimit të pagës së 13-të për vitet kalendarike 2021 dhe 2022. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se palës paditëse i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike, respektivisht mbështetja e bazës juridike në një akt juridik të cilit i ka skaduar afati i vlefshmërisë, paraqet fakt i cili është qartazi në kundërthënie me një fakt që Gjykata e konsideron të njojur. Bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të procedohet tutje me caktimin e seancës gjyqësore për tu vërtetuar faktet e pretenduara nga pala paditëse, për faktin se ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

-Lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës:

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, e lidhur me nenin 463.1 “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vodosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

C.nr. 2023:260608, datë: 21.11.2024

Gj y q t a r i:

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi
është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e
pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes
të kësaj gjykate.